



PROCESVERBAL VI/2025

I mbajtur me rastin e mbledhjes së VI (gjashtë) për vitin 2025 të Komitetit për
Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 19.06.2025
Ora : 13:00

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues
z. Urim Suka
znj. Bulëza Kuçi
znj. Sanije Kuçi Rexhepaj
znj. Fidaije Kukaj
z. Dardan Berisha
z. Liridon Fandaj

Të pranishëm tjerë:

Habibe Bytyqi - Zyrtare për barazi gjinore

Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim
Përfaqësues i OSBE-së
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend Dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-rregullores për bonuset e zonimit për Komunën e Suharekës;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për hapjen e shqyrtimit publik të projekt-dokumentit Plani rregullues i hollësishëm për zonën ekonomike në Duhël;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kornizës afatmesëm buxhetore për periudhën 2026-2028 ;**

Kryesuesi- Përhendet të pranishmit dhe i njofton me rendin e ditës.E hedh në votim rendin e dites:

Aprovohet rendi i ditës

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi-e hedhë në votim pikën 1

Unanimisht miratohet

Pika 2. .Shqyrtimi i projekt-rregullores për bonuset e zonimit për Komunën e Suharekës

Kryesuesi-e laboron pikën dhe hap debatin.

Liridon Fondaj-përshëndet të pranishmit.Kur jemi te kjo projekt-rregullore qysh e ceke edhe vetë nuk ka kalu mbledhjen e kaluar,i njëjti dokument është sjellë përsëri dhe nuk ka asnjë ndryshim,dhe nëse njëherë nuk ka kalu,për me kalu duhet me pas ndonjë ndryshim ose një konsultim paraprak,që ato vrejtje që i kemi dhën na me i pas përball.Përndryshe si projekt-rregullore ne jemi përsëri kundër.

Urim Suka-Përshendetë të pranishmit.Pak a shumë unë i bashkangjitëm asaj qka e tha Liridoni përderi sa na të njejtën projekt-rregullore e kemi diskutu në Asamble dhe e njehta nuk ka ndryshu kurgjo,është pak e pakuptim me ardhë e njëjta.Zakonishtë si projekt-rregullore si LDK ne gati në shumicën e rregulloreve i kemi kalu edhe këtu edhe në Asamblenë Komunale sepse mendojmë që projekt-regulloret që nevojitet Komuna me i pas ne duhet me ja dhan miratimin për me i kry ,mirpo mënyra si na ka ardhë kjo rregullore dhe si dokument i ri për herë të parë,për mu të paktën si Urim e kam thënë edhe në KPF,është kan shumë e paqart,dhe kemi kerku sqarime më teper,në KPF Drejtori mi dha disa sqarime që mu ma krijoj një vizion pak më të qartë për këtë rregullore mirpo tani unë kam kerku që në Asamble me pas një prezantim pak më të mirë dhe me u bind secili Asambleist se qka është duke votu,përkunder Zotimet që i morem atëherë Drejtori nuk i bëri ato prezantime,dhe unë po mendoj që kjo është një diqka që ka ndiku te shumica e Asambleistëve mos me e votu përshkak që nuk e kan pas të qartë.Kur jemi në këtë situat për me i dhën përfundim,përderi sa ne kemi diskutu dhe kemi votu kundër dhe e njëjta tash është dhe ne perseri jemi kunder kësaj projekt-rregullore për me shku në Asamble dhe me u diskutu në Asamble sepse është tem që është kry,u diskutu dhe është votu dhe imponimi menjëherë në seancën e ardhëshme po duket si një lloj presioni me ju bë Asambleistëve,cila është arsyeja e krejt neve që kemi votu kundër tash me votu për.Unë kisha kerku që kjo mos me kalu sot mos me shku për Asamble dhe kjo projekt-rregullore si një dokument i rendesishem që Komuna duhet me pas në Asamblen e re ndër vendimet e para të kryhet kjo projekt-rregullore sepse e kemi edhe shqetësimin që përderi sa kjo rregullore ka ardhë krejt ne fund dhe nuk është duke u përdor edhe për qellime elektorale,për me qenë pak më të qartë dhe të barabartmendoj që

ndër vendimet e para që duhet me i marr të Asambles së re është edhe kjo rregullore dmth jo në këtë fazë që jemi. Vota e LDK për këtë projekt-rregullore është kundër.

Kryesuesi-Faktikisht fjala po bëhet për një projekt-rregullore që është punu nga një grup i ekspert të asaj fushe dhe kjo që po e thua ti ndoshta përdoret për fushat zgjedhore nuk qëndron kjo për arsye se qytetarët e Suharekës nuk jan vetëm të një subjekti politik dhe nuk ka të bëj me fushat zgjedhore. Është rregullore për të mirë të qytetarëve për të ju ofru shërbime më të lehta.

Sanije Kuçi Rexhepaj-përshendetje për të gjithë. Kryesues niveli i bashkëpunimit mes Ekzekutivit dhe Kuvendit Komunal nuk lë shumë për të dëshiruar kjo është nga fillimi i mandatit dhe vazhdon njëjtë edhe sot, sa e her që KPF apo Asambleja Komunal ka kërku nga Ekzekutivi sidomos nga Drejtoria për Urbanizëm sqarime shtesë, ka kërku prezantim, dokumente shtesë dhe nuk na e keni sjellë ndoshta është lluksi i të pasurit votat i mjaftueshëm në Kuvendin Komunal për ti kaluar dokumentet ashtu siq i ofrojnë dhe për të minimizuar kontributin e secilit Asambleist që don me kontribu dhe me dhën një plotësim shtesë për secilën do rregullore apo dokument që e kan sjellë në Asamble Komunale për diskutim dhe ndoshta është qmimi që ka pagu vetë Urbanizmi në mbledhjen e kaluar që nuk është miratu edhe rregullorja për bonus zonimi për arsye se e kam thënë edhe në KPF e kaluar qekjo bonuset e zonimit është një dokument që nuk kuptohet lehtë prej Asambleistëve të tjerë që nuk jan profesionist të fushës, përshtet jam e fushës dhe më është dashtë 2-3 herë me lexu për me e kuptu qartazi se si e kan mendu ekspertat që i përmendet ju, Komisioni që e kan hartu dhe në qfarë forme ka me u apliku, i kam pasë paqartësit e mija i kam përmend edhe mbledhjen e kaluar, por niveli i bashkëpunimit është shumë i mangët. Nëse ishim konsultu ne paraprakisht, nëse na kishin ftu për diskutim dhe për me e plotësu këtë dokument ndoshta qëndrimi jonë do ishte më ndryshe mirpo po sillet e njëjta rregullore që është votu një herë, pse duhet me ndryshu qëndrimi i ndonjërit Asambleist nëse njëher e ka dhën verdiktin e vet. Është pak një situatë presioni, Kuvendi në lajthitje.

Dardan Berisha-Përshendetje për të gjithë. Diskutimet jan bër edhe në seancën e kaluar kemi pasë jashtëzakonisht diskutime rreth kësaj rregullore, realisht nuk deshta me diskutu por u nxita sepse ne seancën e kaluar e kemi votu një pikë të rendit ditës shtesë që e ka propozu anëtari i Kuvendit Selman Kolgeci dhe e kemi votu pa asnjë dokument shtesë dmth Kolega Urim. Shumë shqetësime ka pas me pikat e rendit ditës që i ka sjellë Drejtori Armend me dokumenta komplet, që dmth ne qdo herë po i japim formë politike realisht të njëjtën form po veprojnë të gjithë. Sa i përket hartimit që e tham e kemi diskutu kish punu Komisioni 2 vite për hartimin e kësaj rregullore dhe nuk ma merr mendja që ne jemi eksperta të kësaj fushe. Ne si KPF apo shefa të grupeve mundemi me ja prezantu Asambleistaave tan dhe nuk ma merr mendja që nëse nuk prezantohet me sllajde nuk duhet me u votu një pikë. Sa i përket vonesës është mundu Komisioni me bë një rregullore e cila është prioritet për bizneset dhe para se me e votu një pikë të rendit ditës ne duhet me mendu kujtë po i konvenon kjo pikë e rendit ditës. unë jam Pro për me kalu kjo pikë e rendit ditës.

Urim Suka-Dardani u lidhë me propozimine LDK-së që e kemi pasë në mbledhjen e fundit dhe e kemi votu dhe po thot pse e kemi votu pa pasë të qartë. Unë e kam pas krejt të qartë përderi sa e kam votu. Në qoftë se ti nuk e ke pasë të qartë pse e ke votu?. Vendimi që po foli unë për më herët për prona për mu kur kam votu kundër nuk ka qenë e qartë. dmth dallon diqka kur o kristal psh ki me liru këtë kategori nga QKMF dhe një pronë që ki me ja dhën dikujt kur ti ske pas asnjë dokument përpara me pa qka po ndodhë. Nëse ti e voton këtë rregullore dhe ka operator që presin me marrë favor tash për kësaj rregullore dhe unë po dyshoj që kjo po përdoret për fushat zgjedhore.

Sanije Kuçi Rexhepaj-Dardan ti the që 8 vite nuk ka pas prezantime dhe unë po të tregojë që e ke shumë gabim, nuk është prezantimi vetëm me sllajde power point. Si drejtoreshë e urbanizmit nuk ka pasë pikë të rendit ditës që unë e kam propozu për Asamble Komunale e nuk kam dalë fillimisht me prezantu pikën para se me u hap debati, i ki të gjitha video inqizimet në mbledhje të Asamblesë dhe mundësh me i pa.

Visar Kuçi-Është faktë se në Asamble nuk ka kalu kjo rregullore, kjo rregullore vetëm politik nuk ka, në mbledhjen e kaluar e keni kërku një Mostër dhe është fakt që ne nuk e kemi prur dhe në këtë mbledhje e kam sjellë dhe po ja shpërndaj secilit anëtar. Dy pika i kem të pa qarta prej Asambleistave herën e kalume është kjo pjesa e formulës së koeficientin dhe vendimi e Kryetarit të Komunës që e formon Komisionin. Kjo rregullore është si rrjedhojë e hartës zonale, dmth me hart zonale që Asambleja Komunale

e ka aprovu është e cekur që duhet të formohet një rregullore për bonus zonim. Në bazë të hartës zonale me vendim të kryetarit e kena formu Komisionin, ai komision është i përfaqësuar prej secilës drejtori veq politik nuk ka pas me shumë përgjegjësi ju them se vetëm unë që është deshtë me qenë si udhëheqës i ekipit asnjëri nga drejtorat nuk ka marrë pjesë në hartimin e kësaj rregullore. Si e dini Suhareka ka shumë probleme për dallim nga Komunitet e tjera. Është në të mirë të qytetarëve dhe investitorëve të Suharekës.

Liridon Fondaj-Kur po themi nuk bëhet politik dhe unë pajtohem që nuk bën me bo politik por nëse rregullorja ka ardhur në Asamblë për me u votu dhe ne si përfaqësues duhet me i pas do njohuri më herët, ky Komision nëse është formu që 2 vite u deshtë të paktën me na lajmru edhe neve që është tu u punu në rregullore dhe me na njoftu që edhe ne me dhënë një kontribut. Pjesa tjetër marrëveshja për bonus zonimin te neni 10 thotë që Komisionin e formon Kryetari dhe kët Komision ka mujt me formu Asambleja e jo me i dhënë kompetencë vetëm Kryetarit.

Kryesuesi-e hedhë në votim pikën 2

3 për,4 Kundër nuk kalon, me vendim

të Kryesuesit dërgohet në Asamble

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për hapjen e shqyrtimit publik të projekt-dokumentit Plani rregullues i hollësishëm për zonën ekonomike në Duhël;

Kryesuesi-laboron pikën dhe hap debatin

Sanije Kuçi Rexhepaj-Dokumentet e nivelit të tillë janë shumë të mirpritura për Kuvendin që me i shqyrtu edhe me i hap dyert e shqyrtimeve publike të dokumenteve planifikuese apsolutisht Kuvendi Komunal e ka dhënë vendimin për iniciimin e procedurave, pyetja ime për Drejtorin është A janë përfunduar të gjitha procedurat që kërkohen me ligj për me ardhë deri në këtë pikë që jemi sot?

Visar Kuçi-prej momentit që e ka marrë pëlqimin prej Asamblesë Komunale, e ka siguruar buxhetin, i ka udhëhequr procedurat, e ka përzgjedhur hartuesin. Ekëtij dokumenti, me vendim të Kryetarit të Komunitetit është caktuar ekipi punues. Me sugjerime të ekipit janë bërë takimet dhe kemi ardhë deri në draftin e këtij dokumenti dhe ja kemi dërgu në email, ligjërisht që kërkohet ky dokument me shku në Asamble për miratim për shqyrtim publik, në periudhën 30 ditore ky draftë ka me i marr vrejtjet sugjerimet prej qytetarëve, prej grupeve të interesit, politikës etj.

Sanije Kuçi Rexhepaj-Ligjërisht Komuniteti i takon që në secilën fazë hartuese të dokumenteve të planifikimit hapsinor me organizu diskutime publike për ata që janë të interesuar varësisht nga fushat që e ka plani i hollësishëm në këtë rast që është Zona ekonomike në Duhël. Ju e keni mbajtur vetëm një diskutim publik dhe unë mendoj që ka qenë vetëm gjysë përshkak që kam qenë pjesëmarrës. Diskutimi publik ka qenë për dy Zona industriale, për zonën industriale në Shirokë dhe zonën ekonomike në Duhël dhe ky interferimi i dy tematikave mbrenda për mbrenda një diskutimi publik nuk ka dhënë kurrfarë vlere. As edhe një diskutim publik tjetër dmth bizneset në atë takim kanë qenë të ftuar vetëm biyenesët që operojnë në Zonën industriale në Shirokë. A e keni planë bizneset në Zonën Industriale në Shirokë me i transferu në Zonën Ekonomike në Duhël apo cili ka qenë qëllimi ju që nuk i keni ftuar bizneset tjera jashta Zonës Industrial në Shirokë?

Për mu ka qenë vetëm gjysë diskutimi publik sepse ka qenë ndam për të dy zonat dhe asnjë diskutim tjetër që thotë ligji në secilën fazë të hartimit të dokumenteve të planifikimit hapsinor duhet me u mbajtur diskutime publike e aq më pak unë në atë diskutim kam propozu me u mbajtur edhe anketim. Duke mos i kalu procedurat që janë me ligj nuk e di pse keni ardhë në fazën finale.

Visar Kuçi-Procedurat janë ndjekur të gjitha sipas ligjit.

Kryesuesi- e hedhë në votim pikën 3

3 për,4 Kundër nuk kalon, me vendim të Kryesuesit dërgohet në Asamble

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kornizës afatmesëm buxhetore për periudhën 2026-2028 ;

Kryesuesi-Laboron pikën dhe hap debatin

Urim Suka-Është e disa herë që ne po diskutojmë për kornizën dhe gati është formula e njëjtë dhe kur ne po e ngrisim një shqetësim ju po na e ktheni në personale.Për dallim nga herave tjera para se me ardhë kjo kornizë tek ne,ne e kemi mbajtur një diskutim mes shefave të grupit dhe e kemi pas mundësin që disa vrejte me i dhan në atë takim që ndoshta ky dokument me u përmirsu pak.Ky dokument që na ka ardhë në krahasim me vitin e kaluar ky është më keq i planifikun.Ky dokument ka nevojë me u përmirsu.Është mirë me u bë më i specifikun dhe me ju dhën prioritet fshatrave më të nevojshme psh fshatrat që kanë banor më shumë etj.Nëse ne e bëjm planifikimin më të mirë mundësia që nesër me pas investime më të mira më të qëllume për qytetarët është më e madhe,po kem qef me dhën Kontributin edhe ne që planifikimet me qenë më të mira.Nuk e di a kem hapsirë me mbajtur takim të veçantë me i dhanë kontributët që me u ndryshu me bë një plotësim ndryshim që ky dokument më u bë i mirë nëse nuk kem ne në këtë fazë nuk mundemi me përkrahë.

Liridon Fondaj-Nuk ka asnjë sen më të mirë se vitet e kalume,unë po flasë për fshatin tim jetike është uji dhe ne nuk kemi,këto rrugë tash që janë oborret dhe vota ime është kundër.

Fadil Hoxha-përshendetje për të gjithë,këto emra që ne i kemi qitë në KAB te lista e projekteve kapitale këto janë emra që është dashtë me i qitë te pjesa e par dhe këta emra tek qarkorja e dyt mundet me u ndryshu 100%.Kur e keni marrë materialin është dashtë me ardhë me propozime konkrete dhe ne e kishim bë ndryshimin.

Dardan Berisha- në ndëgjime publik i kam paraqit 3 kërkesa për fshatin kanë qenë edhe në procesverbal por këtu nuk janë.

Fadil Hoxha-kam një propozim,në Asamble le ti sjellin rekomandimet dhe gjatë asaj kohe unë i ndryshoj dhe i dorozojë.

Kryesuesi -e hedhë në votim pikën 4 me ndryshime

3 për, 4 Kundër nuk kalon,me vendim të Kryesuesit dërgohet në Asamble

Takimi përfundoi 14:35